

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

QuantX IT Solutions

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

M31904013D

NUIS/NIPT

Rruga e Dibres , Njesia administrative Nr 8 Tirane, Vila nr.153, Kati i Pare zona kadastrale nr 8360

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0672073031

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

doelmehmeti@gmail.com

E-mail

Administrator Dorjana Mehmeti

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2024/02/29

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0672073031

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-96506-02-27-2024

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Bashkia Durres

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

5794043

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Blerje paisje Tik për Bashkinë

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2024/03/11

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmëri të kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2024/03/11

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/40032/02272024

30200000-1

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

? Ligji 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (LPP)

? Ligjin Nr.9936, Datë 26.6.2008 Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor, i ndryshuar (Ligji për Sistemin Buxhetor)

? VKM nr.285 datë 19.05.2021 “RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK (RrPP)

? Rekomandimi Nr.7998 të datës 24.12.2021 i Agjencisë së Prokurimit Publik

? Jurisprudencë: Vendimi i GJED Çështja C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Holandës”

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

Shoqëria QuantX IT Solutions është një shoqëri tregtare e themeluar dhe organizuar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti shitblerje, konsulencë dhe ekspertizë në fushën e pajisjeve elektronike, kompjuterike, softuerike, IT/ ICT.

Si një shoqëri tregtare ofrojmë mallrat dhe shërbimet tona edhe në fushën e prokurimit publik duke paraqitur një interes të vecantë në fushën e ofrimit të produkteve cilësorë të IT dhe zgjidhje inovative me vizionin e qartë për përmirësimin e shërbimeve publike.

Autoriteti Kontraktor (AK) Bashkia Durrës, për nevojat e tij ka shpallur në portalin e prokurimit publik të APP, procedurën e prokurimit të llojit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me nr : REF-96506-02-27-2024, me objekt “Blerje pajisje Tik për Bashkinë” me fond limit 5,794,043 (pesë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyzet e tre) lekë pa TVSH..

Nga këqyrja e dsokumentave standarte të tenderit, konkretisht në kriteret e vecanta të kualifikimit, evidentojmë që janë vendosur kriteret të tepërta nga AK Bashkia Durrës dhe nisur nga ky fakt, po ushtrojmë të drejtën tonë për ankim në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar.

Konkretisht kundërshtojmë kërkesat për kualifikim, si vijon:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.3 Kapaciteti teknik:

b. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

? 3(tre) punonjës të specializuar në fushën e IT ose Elektronikës

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

a. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

ISO 20000-1 - Certifikimi I Sistemit Për Menaxhimin E Shërbimeve Të Teknologjisë Informative (ose ekuivalente).

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

? Në lidhje me legjitimitetin ankimit

Legjitimiteti aktiv (legittimatio activa) i palës në një proces gjyqësor/administrativ nënkupton interesin legjitim dhe të vërtetë që duhet të ekzistojë ndërmjet palës dhe cështjes në shqyrtim. Interesi legjitim lidhet me të drejtën e e palës për të kërkuar nëpërmjet gjykatës/organeve administrative të shqyrtimit/apelimit njohjen ose rivendosjen e një të drejte të mohuar ose cënuar prej dikujt tjetër.

? Në lidhje me afatin e ankimit, legjitimitetin racione temporis

Në mbështetje të nenit 110 “Afatet për ankim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, e drejta për ankim lind nga operatret e interesuar, në rastin konkret, si vijon:

2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

Njoftimi i publikimit të procedurës së prokurimit publik, është publikuar në datën 28/02/2024, prandaj QuantX IT Solutions legjitimohet racione temporis, sepse e ka paraqitur ankesën brenda afatit të përcaktuar 7 ditor për ankesat, sipas ligjit, njëkohësisht në AK dhe KPP.

? Mbi themelin e ankimit

Pika 1.

AK Bashkia Durrës, në DST , në kriteret e vecanta të kualifikimit , ka kërkuar:

2.5 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

b. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Kjo kërkesë, sipas gjykimit tonë, përbën një kërkesë të tepruar dhe jo proporcionale me llojin dhe vështirësinë e kësaj procedure prokurimi publik.

Paraqitja e bilanceve nuk është nevojshme në procedurat e prokurimit publik të llojit “procedurë e hapur e thjeshtuar”, prandaj vendosja e kësaj kërkesë nga ana e AK Bashkia Durrës është në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit të prokurimit publik në fuqi në RSH.

Risjellim në vëmendje që procedura e prokurimit është “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, procedurë kjo e bazuar në nenit 55 të VKM Nr.285 datë 19/05/2021 “Rregullat e Prokurimit Publik”, dhe shprehimisht përcaktohet se për përmbushjen e kapacitetit financiar, mjafton vetëm paraqitja e

deklaratave/vërtetimit të xhiros vjetore, citoj:

Neni 55

Procedurë e hapur e thjeshtuar

4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

Prandaj duke u bazuar në referencën ligjore të mësipërme, konkludojmë se kërkesa:

2.6 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

c. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Është vendosur në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik dhe si e tillë, duhet hequr.

? Kërkesa 1:

Kërkesa: “2.6Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

c. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit..” TË HIQET.

Pika 2:

AK Bashkia Durrës, në DST , në kriteret e vecanta të kualifikimit , ka kërkuar:

c. ”Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

? 3(tre) punonjës të specializuar në fushën e IT ose Elektronikës

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikatën perkatese, kualifikimin perkatese ose licencën.”

Kjo kërkesë, sipas gjykimit tonë, përbën një kërkesë të tepruar dhe jo proporcionale me llojin dhe vështirësinë e kësaj procedure prokurimi publik.

Risjellim në vëmendje që procedura e prokurimit objekt ankimi është procedurë e llojit ‘Procedurë e hapur e thjeshtuar’, për blerjen e pajisjeve kompjuterike dhe printerave për Bashkinë Durrës, konkretisht blerjen e 33 kompjuter laptop dhe 12 fotokopjesh.

Nuk kërkohet asnjë instalim, konfigurim dhe lidhje me rrjetin e brendshëm të institucionit apo ndonjë punë tjetër që do të legjitimonte a priori pasjen e 3 specialistëve me formim It ose Elektronikë.

As në formularin e argumentimit të kriterëve, nuk është paraqitur asnjë argument bindës juridik dhe teknik se pse nevojiten 3 punonjës të specializuar në fushën e IT ose Elektronikës dhe kjo përbën në vetvete vendosjen e një kriteri jo proporcional me procedurën e prokurimit.

Në Rekomandimin Nr.7998 të datës 24.12.2021 i Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), kjo e fundit e ka vendosur theksin në më shumë se një herë tek fakti që AK duhet që të vendosin kriterë që të kenë lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Në rekomandim APP shpreh në mënyrë të qartë se:

Sjellim në vëmendje të autoriteteve/enteve kontraktore që kriteret e vendosura duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, si dhe duhet të kufizohen vetëm në ato kriterë që janë të përshtatshme për të garantuar kapacitetet e nevojshme të operatorit ekonomik për zbatimin e kontratës që prokurohet.

Togëfjalëshat kyc janë “ të kenë lidhje “ dhe “të jenë proporcionale”.

Duke qenë se nuk ka lidhje me objektin e kontratës, automatikisht nuk është as kriter proporcional në kuptim të parashikimeve të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77, citoj:

Neni 77

Kërkesat për kualifikim

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

AK nuk mund të vendosë kriterë tenderi të panevojshme për realizimin e kontratës, kriterë të cilat as nuk mund ti argumentojë ligjërisht dhe teknikisht me nevojën për realizimin e kontratës, kështu duke shkelur parimin e proporcionalitetit në vendosjen e kriterëve.

Prandaj duke u bazuar në referencën e mësipërme, konkludojmë se kërkesa:

b.”Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

? 3(tre) punonjës të specializuar në fushën e IT ose Elektronikës

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikatën perkatese, kualifikimin perkates ose licencën.”

Është vendosur në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik dhe si e tillë, duhet hequr.

? Kërkesa 2:

Kërkesa:

“b.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

? 3(tre) punonjës të specializuar në fushën e IT ose Elektronikës
Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikatën perkatese, kualifikimin perkates ose licencën.”TË HIQET.

Pika 3:

AK Bashkia Durrës, në DST , në kriteret e vecanta të kualifikimit , ka kërkuar:

2.7 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

b. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

ISO 20000-1 - Certifikimi I Sistemit Për Menaxhimin E Shërbimeve Të Teknologjisë Informative (ose ekuivalente).”

Kërkesë të cilën e kundërshtojmë pasi është një kërkesë që nuk ka asnjë lidhje me objektin e prokurimit.

Risjellim në vëmendje që procedura e prokurimit objekt ankimi është procedurë e llojit ‘Procedurë e hapur e thjeshtuar’, për blerjen e pajisjeve kompjuterike dhe printerave për Bashkinë Durrës, konkretisht blerjen e 33 kompjuter laptop dhe 12 fotokopjesh.

Nuk ka asnjë përshkrim/kërkesë ku kërkohet kryerja e shërbimeve të IT për të cilën mund të vlerë një certifikatë e sistemit të menaxhimit të shërbimeve të IT, në DST, në procesverbal apo edhe në dokumentin e specifikimeve teknike.

Me një kërkim të thjeshtë në internet mbi standartin ISO 2000-1 Certifikimi I Sistemit Për Menaxhimin E Shërbimeve Të Teknologjisë Informative (ose ekuivalente), gjejmë që në fakt objekti i këtij certifikimi ka të bëjë me: “Të gjitha aspektet e menaxhimit të shërbimit të TI-së, duke përfshirë projektimin, tranzicionin, ofrimin dhe përmirësimin e shërbimit, mbulohen nga objekti i ISO/IEC 20000. Proceset, duke përfshirë ofrimin e shërbimit, menaxhimin e nivelit të shërbimit, menaxhimin e incidenteve dhe problemeve, menaxhimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e ndryshimeve , etj”

Ndërkohë, po ti referohemi dokumentit të specifikimeve teknike dhe dokumentave standartë të tenderit të publikuara nga AK Bashkia Durrës në tenderin objekt të këtij ankimi, rezulton se nuk ka asnjë term/aspekt të “menaxhimit të shërbimit të TI-së, duke përfshirë projektimin, tranzicionin, ofrimin dhe përmirësimin e shërbimit, mbulohen nga objekti i ISO/IEC 20000. Proceset, duke përfshirë ofrimin e shërbimit, menaxhimin e nivelit të shërbimit, menaxhimin e incidenteve dhe problemeve, menaxhimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e ndryshimeve”, prandaj është një kërkesë që nuk ka asnjë lidhje me objektin e prokurimit dhe shërben vetëm për të kufizuar konkurrencën në këtë procedurë tenderi.

Duke qenë se nuk ka lidhje me objektin e kontratës, automatikisht nuk është as kriter proporcional në kuptim të parashikimeve të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77, citoj:

Neni 77

Kërkesat për kualifikim

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Prandaj duhet të modifikohet,

? Kërkesa 3:

Kërkesa: “a. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

ISO 9001- Menaxhimi i Cilësisë së Kompanisë (ose ekuivalente).

ISO 27001- Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (ose ekuivalente)

ISO 20000-1- Certifikimi I Sistemit Për Menaxhimin E Shërbimeve Të Teknologjisë Informative (ose ekuivalente)”

të modifikohet dhe të bëhet:

“a. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

ISO 9001 - Menaxhimi i Cilësisë së Kompanisë (ose ekuivalente).

ISO 27001- Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (ose ekuivalente)”.

AK duhet të ketë parasysh në cdo rast se parimet e LPP, si pjesëmarrja e gjerë, konkurrenca mes operatorëve ekonomikë dhe integriteti i procedurës së prokurimit, janë postulate të padiskutueshme të integritetit dhe besimit në procedurat e prokurimit publik.

Dispozitat më poshtë, e parashikojnë në mënyrë eksplicite se çfarë duhet të ketë parasysh AK:

Neni 2

Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të

padrejtë operatorë ekonomike të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Neni 21

Autoriteti ose enti kontraktor

1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Neni 87

Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

Dhe neni 45 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK, citoj;

Neni 45

Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit, të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

Po ashtu vendosja e këtyre kriterëve përbën një shkelje të Kodit të Procedurave Administrative në RSH, neni 13, neni 14, citoj:

Neni 13

Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë

Në ushtrimin e funksioneve të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie.

Neni 14

Parimi i objektivitetit

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën admini-strative.

Autoritet Kontraktore duhet të marrin parasysh që procedurat e tenderit duhet të jenë të formuluar në një formë që të nxisin konkurrencën e lirë mes operatorëve, sic përcakton edhe vendimi i GJED Çështja C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike.

Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”

Duke iu referuar një ndër qëllimeve kryesore të ligjit ku parashikohet se efienca, efikasiteti dhe mirëpërdorimi i fondeve publike, konkretisht neni 2, citoj:

Neni 2 Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik.
 - b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- janë postulate të padiskutueshme në referim të këtij ligji, Autoritetet Kontraktore duhet të mbajnë parasysh që të prokurojnë mallra shërbime punë në mënyrë sa më efektive duke përfituar një cmim sa më të ulët.

Dhe cmimet e ulta dhe konkurrese e bën një procedurë ku ofron shance të barabarta për të gjithë ofertuesit e mundshëm, pra duke mos aplikuar kritere përjashtuese, kritere që nuk kanë lidhje me objektin e procedurës së prokurimit dhe/ose kritere që orientohen drejt një ofertuesi të caktuar apo një grupi ofertuesish, që automatikisht kufizon konkurrencën, rrjedhimisht duke bërë që të ofrohen cmime më të larta.

Kjo sjellje bie ndesh edhe me legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH, konkretisht Ligjin Nr.9936, Datë 26.6.2008 Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ku parashikohet se institucionet duhet të kenë parasysh përdorimin eficient të fondeve publike, konkretisht neni 3 dhe neni 4 i ligjit, citoj:

Neni 3 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Buxhet” është tërësia e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes qendrore e vendore dhe të fondeve speciale, të cilat miratohen me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë, më poshtë “Kuvendi” ose me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.

Neni 4 Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor janë:

- ç) përdorimi ekonomik, eficient dhe efektiv i burimeve publike;

ku përcaktimi në ligj është shterues që është detyrë kryesore e intitucioneve mirëmenaxhimi i fondeve publike. Në këtë kuptim, AK, duke kufizuar konkurrencën, automatikisht keqmenaxhon edhe fondet publike.

Për të konkluduar QuantX IT Solutions shpk në vazhdim të arsytimit të paraqitur më lart, i gjykon më se të drejta e të ligjshme pretendimet e paraqitura.

Për sa kemi paraqitur më sipër, në dritën e fakteve, bazuar në legjislacionin përkatës, përfundimisht kërkojmë:

1. Pranimin e ankesës sonë.

2. Kërkesa: “2.6Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.” TË HIQET.

3. Kërkesa: “b.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë: 3(tre) punonjës të specializuar në fushën e IT ose Elektronikës Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikaten perkatese, kualifikimin perkates ose licencen.”TË HIQET.

4. Kërkesa: “a.Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

ISO 9001 - Menaxhimi i Cilësisë së Kompanisë (ose ekuivalente).

ISO 27001 - Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (ose ekuivalente)

ISO 20000-1 - Certifikimi I Sistemit Për Menaxhimin E Shërbimeve Të Teknologjisë Informative (ose ekuivalente)”

të modifikohet dhe të bëhet:

“a. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

ISO 9001 - Menaxhimi i Cilësisë së Kompanisë (ose ekuivalente).

ISO 27001 - Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (ose ekuivalente)”.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

jo

7. Lista e informacionit konfidencial:

Informacione teknike, ekonomike, që nuk gjenden ne regjistra publike.

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

doelmehmeti@gmail.com

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Dorjana Mehmeti